




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Den. Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. i llog. Broj. shënime <u>02</u> Nr. paqes	Nr. Prot. Broj. Prot. <u>01-2107/2012</u> Data Datum <u>13.06.2012</u>



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.06.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-5108/11,për Zyrtarin e Lartë z.Ilaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marre gjatë kontrollit të formularit për deklaram të pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-5108/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Ilaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan, ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si Pronar dhe person i autorizuar ne biznesin Individual OS “Asepsa” ne Gjilan që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 06.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Illaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 13.04.2012 është mbajtur takimi me, z.Illaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan, gjatë takimit, është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i lartë, Poroshtica, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirë po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar as kush se kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit. Dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtaret e AKK-së, e kanë njoftuar z.Illaz Poroshtica, për situatën e cila paraqet mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

z. Illaz Poroshtica, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet në këto biznese, dhe do të largohet nga funksioni menaxhues person i autorizuar në biznes.

Me datën 25.05.2012, Zyrtari i lartë, z.Illaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan ka dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit dëshmitë e lëshuar nga ARBK-ja, ku shihet se z.Illaz Poroshtica nuk ka me pozitën e personit të autorizuar në biznesin OS "Asepsa" në Gjilan, por ka mbetur vetëm si pronarë.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatohet se :

Zyrtari i lartë z.Illaz Poroshtica, Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej, pasi që nuk mbanë me pozitën e personit të Autorizuar në biznesin e lartë cekura. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri me funksionin publik si Kryeshef i Departamentit të Kirurgjisë, në Spitalin Rajonal Gjilan.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

